



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	11.08.2025
REFERENC-Ë:	642-25-4085-1-1-1
PËR/ZA/TO:	Operatori Ekonomik: “Inovix” SH.P.K.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Zyra e Prokurimit - Kushtrim Mehaj – Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim për Aktivitetin e Prokurimit “Furnizim me material Stomatologjik, paisje Stomatologjike dhe material Laboratorik”, me nr. të prok: 642-25-4085-1-1-1

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Mitrovicës Jugore në mbështetje të nenit 63.1.1 pika (b) të Rregullorës Nr.002/2024 për Prokurim Publik duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Operatori Ekonomik: “Inovix” SH.P.K., të datës 08.08.2025 në ora 15:09 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “*Furnizim me material Stomatologjik, paisje Stomatologjike dhe material Laboratorik*”, LOT 2 me nr. të prok: 642-25-4085-1-1-1, kundër NJOFTIMIT për kontratë, dokumentet e tenderit të datës 15.05.2025, Autoriteti Kontraktues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar me datë 08.08.2025, nga Operatori Ekonomik: “Inovix” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit: “*Furnizim me material Stomatologjik, paisje Stomatologjike dhe material Laboratorik*”, LOT 2 me nr. të prok: 642-25-4085-1-1-1, kundër NJOFTIMIT për kontratë, dokumentet e tenderit të datës 15.05.2025.
2. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim për Kontratë dokumentet e tenderit e AK-së për aktivitetin e prokurimit me titull: “*Furnizim me material Stomatologjik, paisje Stomatologjike dhe material Laboratorik*”, LOT 2 me nr. të prok: 642-25-4085-1-1-1.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: “Inovix” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit *Furnizim me material Stomatologjik, paisje Stomatologjike dhe material Laboratorik*, LOT 2 me nr. të prok: 642-25-4085-1-1-1, ka bërë Kërkesës për Rishqyrtim me datë 08.08.2025 kundër NJOFTIMIT për kontratë, dokumentet e tenderit e Autoritetit Kontraktues të datës 15.05.2025 sipas pretendimeve si në vijim:

PRETENDIMT ANKIMORE:

Bashkëngjitur e gjeni pretendimin ankimor nga Operatori Ekonomik: “Inovix” SH.P.K. si në vijim:

Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj një Deklaratë nga prodhuesi apo distributori i autorizuar i prodhuesit i reagensave se këto reagensa janë kompatible për aparatet të cilat i disponon QKMF-ja ‘Mindray dhe Gessan’, si dhe operatori ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën e specialistit nga prodhuesi i aparatit që e posedojmë “Mindray dhe Gessan” i cili do të bëjë aplikimin e testeve në aparat për (pozicionin 1 deri 51). Kjo kërkesë vlenë vetëm për LOT 2.

Kjo kërkesë, në formën e saj aktuale, përbën një shkelje të disa parimeve themelore të prokurimit publik, të cilat përmbledhen si vijon: • Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë

transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. oShkelje: Kërkesa nr. 5 favorizon në mënyrë të padrejtë operatorë të caktuar që kanë marrëveshje ekskluzive me prodhuesit e pajisjeve “Mindray” dhe “Gessan”, duke diskriminuar të gjithë operatorët e tjerë që mund të ofrojnë këto produkte pa pas nevojë për Autorizim dhe certificate të serviserit nga prodhuesi. Dorëzimi i një autorizimi dhe certificate nga serviseri i autorizuar i aparatit ekzistues nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë, funksionalitetin apo përputhshmërinë e reagensave që janë objekt i kontratës. Objekti i tenderit është furnizimi me reagensa, jo mirëmbajtja apo kalibrimi i pajisjeve, dhe si e tillë, kjo kërkesë është jashtëzakonisht kufizuese dhe e pajustificuar në këtë kontekst. • Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve oShkelje: Kjo kërkesë shton një element vlerësimi të pajustificuar që nuk lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e produktit, por me burimin e autorizimit për përputhshmëri, duke krijuar një kriter të panevojshëm që ndikon negativisht në konkurrencë. • Neni 60 – Kriteret për Dhënie të Kontratës Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji. oShkelje: Kjo kërkesë pengon operatorët të konkurrojnë në kushte të barabarta për të ofruar ofertën më të favorshme, pasi vendos barrierë të panevojshme për kualifikim. • Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale 1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në 5/6 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen. oShkelje: Në vend që të kërkojë që operatori të dëshmojë përvojën e tij dhe aftësinë për të kryer kontratën, kërkesa nr. 5 delegon përgjegjësinë e kualifikimit të një palë të tretë (prodhuesi i aparatit), gjë që bie ndesh me frymën e nenit 69, i cili synon të vlerësojë kapacitetin e operatorit ekonomik vetë. Vlen të ceket që përdorimi i reagensave nuk kërkon ndërhyrje nga serviseri, në praktikë, aplikimi i reagensave në aparatet laboratorike bëhet nga personeli mjekësor i institucionit publik, dhe jo nga serviseri. Nuk ka asnjë bazë teknike apo legjislative që e bën të detyrueshme përfshirjen e një serviseri të autorizuar për një veprim që është i zakonshëm dhe rutinor në përdorimin e aparateve

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMET ANKIMORE NDAJ OE “Inovix” SH.P.K.:

Autoriteti Kontraktues ju njofton se Kërkesa 5. Është në përputhje me kërkesën e Njësisë së Kërkesës pasi që OE duhet të dorëzojë certifikatën e specialistit nga prodhuesi i aparatit që e posedojmë si QKMF, vlen për arsye se shumica e pajisjeve laboratorike ju nevojitet kalibrimi dhe për saktësi duhet të bëhet sipas normave të caktuara nga prodhuesi dhe këtë e ka obligim OE fitues ta sigurojë gjatë periudhës kontraktuale. AK ka pas edhe kërkesë për sqarim për këtë Kërkesë 5, gjithëashtu keni qenë të informuar në afatin fillestar edhe me përgjigje nga AK. Andaj kjo kërkesë mbetet e njëjta dhe nuk mund të ndryshohet.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues ju njofton se kërkesa është parashtruar jashtë afatit ligjor për elementet e pandryshuara të dosjes së tenderit.

Ku sipas nenit 60 të Rregullores dhe Interpretimit të KRPP-së, kërkesa për rishqyrtim lidhur me njoftimin për kontratë apo dokumentet e tenderit duhet të parashtrohet së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Ky afat nuk aplikohet në rastet kur Autoriteti Kontraktues bënë zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave. AK ka bërë zgjatjen e afatit pas Vendimit të OSHP-së ku ka kërkuar që të zgjatet afati pas një kërkesë për rishqyrtim në fazën fillestare para hapjes së ofertave. Andaj kjo kërkesë për rishqyrtim konsiderohet si e jashtëafatshme.

Ju nuk keni ushtruar të drejtën për rishqyrtim në afatin fillestar ligjor, edhe pse kriteret për Kërkesën 5 e në dosjen e tenderit kanë qenë të njëjta edhe para korrigjimeve të fundit.

Korrigjimet e bëra nuk kanë krijuar rrethana të reja që të justifikojnë afat të ri për rishqyrtim.

AK ka hequr disa kritere, por nuk ka ndryshuar apo shtuar kritere të reja për të cilat ju po ankoheni.

Zgjatja e afatit për dorëzim të ofertave është bërë vetëm pas marrjes së Vendimit të OSHP-së për të larguar një Kriter pas kërkesës për rishqyrtim nga një OE në afatin fillestar para hapjes së ofertave që ka qenë 27.06.2025, dhe kjo kërkesë për rishqyrtim nga ana e juaj nuk përbën bazë ligjore për elemente të pandryshuara në DT dhe NJK.

Kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit janë të justifikuara teknikisht dhe nuk konsiderohen diskriminuese, por janë të domosdoshme për të siguruar standardin dhe cilësinë e kërkuar të furnizimeve dhe shërbimeve.

Bazuar në të dhënat e lartëcekura Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe Legjislacionit sekondar të LPP-së.